



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

V E N D I M

Nr. 97, Datë 97/05/2022

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 76, datë 12.05.2022, e z. A.K., ku pretendohet diskriminim për shkak të gjinisë, aftësisë së kufizuar dhe për çdo shkak tjetër, nga ana e z. A.Y., gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri²,

K O N S T A T O I:

I. Pretendimet sipas subjektit ankues.

Referuar informacionit të formularit të ankesës së depozituar pranë KMD-së, rezulton se ankuesi A.K. ka patur konflikte familjare, të cilat ai pretendon se kanë ardhur si rrjedhojë e problemeve ekonomike dhe gjendjes së tij shëndetësore. Ankuesi sqaron se pas debateve të fundit, bashkëshortja e tij është larguar nga shtëpia dhe e ka paditur në polici. Ai sqaron se gjyqtari A.Y. ka pretenduar se ai ka thyer urdhërin e mbrojtjes ndaj bashkëshortes së tij, ndërkohë që z. A.K. sqaron se ai nuk ka patur dijeni që ekziston një urdhër i tillë dhe se ai ka qëndruar në shtëpinë e tij.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Ankuesi pretendon se është diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar, pasi vendimet e marra nga policia dhe gjykata mbi thëniet e bashkëshortes së tij janë marrë të mirëqëna, pa e marrë fare në pyetje atë. Ai sqaron se është me aftësi të kufizuara dhe nuk mund të bëjë veprime të tilla për shkak të sëmundjes.

Njëkohësisht, ai sqaron se është njoftuar vetëm për seancën gjyqësore dhe gjyqtari nuk e ka lejuar të futet në sallë në seancën e parë. Ai ka marrë pjesë në seancën e dytë pa praninë e psikologut dhe pa patur një avokat. Ankuesi sqaron se ndihet i diskriminuar nga gjyqtari, pasi ky i fundit ka deklaruar se është përsëritës. Z. A.K. sqaron se deklarim i tillë nga gjyqtari nuk kishte arsye pse të bëhej për sa kohë që dënimet e tij të mëparshme janë kryer dhe nuk ka arsye pse ai të paragjykohet për një gjë të tillë.

Ankuesi shprehet se me vendim gjyqësor, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur urdhër mbrojtjeje për bashkëshorten e tij, duke mos e lejuar ankuesin të jetojë në një shtëpi me të, ndërkohë që ai nuk ka shtëpi tjetër ku të banojë. Këtë, ankuesi e konsideron diskriminim gjinor dhe për shkak të aftësisë së kufizuar, pasi shteti nuk i ka ofruar asnjë banesë tjetër, ku të jetojë dhe se ai është person me aftësi të kufizuara dhe si i tillë nuk mund të nxirret në rrugë. Në këtë kontekst, ankuesi thekson faktin se dispozitat ligjore që kryejnë parashikime të tilla janë diskriminuese, pasi i japin përparësi gruas, e cila thjesht bën një deklaratë në polici si e dhunuar dhe ai nxirret jashtë nga shtëpia pa u marrë në pyetje dhe pa prova, në kushtet kur ai është me aftësi të kufizuara. Ai shprehet se nëse ligji e nxjerr burrin jashtë nga shtëpia kur është dhunues, duhet të kryejë parashikimet përkatëse se ku duhet të strehohet. Ai shprehet se duhet të ishte marrë në pyetje në praninë e psikologut dhe jo të vendosej që të mos jetonte në shtëpinë e tij.

II. Procedurat e ndjekura nga Komisioneri

Pas kryerjes së verifikimit paraprak të ankesës dha akteve bashkëlidhur saj, KMD gjykoj se kjo ankesë duhej plotësuar me informacion vijues. Për këtë arsye, strukturat përgjegjëse të KMD-së iu drejtuan me e-mailin e datës 16.05.2022, specialistes së Zyrës Rajonale Shkodër të KMD-së, ku iu kërkua të kontaktonte me ankuesin dhe të administronte informacionin vijues:

- ✓ *“Kopje e plotë e Vendimit nr.84 (1757), datë 04.05.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, nëpërmjet së cilit është lëshuar urdhër mbrojtjeje për bashkëshorten e ankuesit.*
- ✓ *Vendimi nr. 76 (1447), date 17.04.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, nëpërmjet së cilit është lëshuar urdhër mbrojtjeje për bashkëshorten e ankuesit.*
- ✓ *Informacion nëse z. A.K. ka bërë ankim në Gjykatën e Apelit Shkodër, kundër vendimeve të sipërcituara.*

- ✓ *Informacion mbi numrin e vendimeve të gjykatës së sipërcituar që kanë përcaktuar urdhëra mbrojtjeje të bashkëshortes së z. A.K.;*
- ✓ *Çdo akt njoftues i gjykatës së sipërcituar drejtuar ankuesit A.K..*
- ✓ *Referuar formularit të ankesës rezulton se subjekti kundër së cilit drejtohet ankesa është gjyqtari i sipërcituar. Në këtë kontekst, të përcaktohen qartësisht momentet e pretenduara si diskriminuese nga ana e tij.*
- ✓ *Referuar shënimeve në formularin e ankesës, rezulton se ankuesi ankohet edhe ndaj dispozitave ligjore që kanë mundësuar strehimin e gruas në banesën e përbashkët dhe largimin e z. A.K. në cilësinë e dhunuesit nga shtëpia. Të përcaktohen saktësisht dispozitat ligjore, për të cilat pretendohet diskriminim gjinor dhe për shkak të aftësisë së kufizuar.”*

- Në përgjigje të e-mailit të dërguar nga Komisioneri, Specialistja e Zyrës Rajonale Shkodër të KMD-së dërgoi e-mailin e datës 18.05.2022, ku citohet se:

“Sa i përket vendimit nr. 84 (1757), datë 04.05.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ankuesi u shpreh se ende nuk është zbardhur nga gjykata (pritet javen që vjen)

-Sa i përket ankimimit të vendimit ankuesi po pret zbardhjen e vendimit për të apeluar vendimin.

-Sa i përket dispozitave ligjore bëhet fjalë për dispozitat që parashikojnë largimin e dhunuesit nga shtëpia (ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar). Paragrafi i parë i pikës 1, të nenit 10, ndryshohet si më poshtë: “1. Gjykata, si masë mbrojtëse të dhunës në familje, urdhëron menjëherë largimin e dhunuesit nga banesa për një afat kohor të caktuar, kur viktimat dhe dhunuesi banojnë në të njëjtën shtëpi. Gjykata, kur është rasti, në vendosjen e kësaj mase merr në konsideratë nevojat e veçanta të dhunuesit të mitur, të moshuar ose personit me aftësi të kufizuar dhe në këto raste urdhri i largimit nga banesa vendoset vetëm kur asnjë masë tjetër nuk garanton mbrojtjen e viktimës nga dhuna.” Pra, sipas ankuesit nuk janë marrë në konsideratë nevojat e veçanta si person me aftësi të kufizuar (lidhur me këtë ankuesi pretendon diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar) nga gjykatësi dhe në vetvete nxjerrja e dhunuesit nga shtëpia pa i siguruar një strehë dhe po që se dhunuesi nuk është me aftësi të kufizuar përbën diskriminim gjinor- pretendon ankuesi.”

Mbështetur në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se:

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të “aftësisë së kufizuar”, “gjinisë” dhe “për çdo shkak tjetër” duke përcaktuar se: “Ky

ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 3, i ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Në Kreun III, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pika 1, të tij parashikon se: “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”

Në bazë të dispozitave të LMD, të ndryshuar, ankesat e depozituara pranë KMD-së shqyrtohen nga ky institucion dhe në përfundim të procedurave hetimore Komisioneri shprehet me vendimmarrje, nëpërmjet së cilës kryesisht konstaton ose jo diskriminimin e pretenduar për një ose disa nga shkaqet e përcaktuara në nenin 1 të këtij ligji.

Ankesa e z. A.K. mbështetet në dy pretendime, ku i pari konsiston në pretendimin për diskriminim nga ana e gjyqtarit A.Y., pasi ky gjyqtar ka lëshuar vërtetimin e një urdhëri mbrojtjeje për bashkëshorten e z. A.K., duke vendosur largimin e ankuesit nga banesa e përbashkët. Pretendimi i dytë i ankuesit konsiston në përmbajtjen diskriminuese, për shkak të

gjinisë dhe aftësisë së kufizuar, të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

➤ **Lidhur me pretendimin e parë, KMD gjykon se:**

Mbështetur në dokumentacionin e depozituar në cilësi prove rezulton se z. A.K. është diagnostikuar se vuan nga “skizofrenia paranoide”. Me Vendimin nr. 12, datë 13.01.2022 e KMCAP Shkodër, ai është përcaktuar si invalid i plotë pune, duke u cilësuar se nuk është i aftë për asnjë punë.

Në nenin 12, të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Organi kompetent për lëshimin e urdhrave mbrojtës në rastin e dhunës në familje është gjykata e juridiksionit të përgjithshëm e shkallës së parë. Për të vendosur sigurimin e masave mbrojtëse të përmendura në nenin 10 të këtij ligji, gjykata lëshon urdhra mbrojtjeje dhe urdhra të menjëhershëm mbrojtjeje.

2. Pala e interesuar mund t'i kërkojë gjykatës, sipas rastit, konform dispozitave të këtij ligji, lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, pa kërkuar paraprakisht nxjerrjen e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes.

3. Pasi gjykata të ketë lëshuar një urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje, pala e interesuar mund të kërkojë lëshimin e një urdhri mbrojtës, siç parashikohet në këtë ligj. Urdhri mbrojtës përkatës shërben për të rikonfirmuar vazhdimësinë e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, si dhe siguron masat mbrojtëse të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji.”

Mbështetur në sa më sipër, rezulton se bashkëshortja e z. A.K. ka depozituar kërkesëpadi pranë Gjykatës së Rrethit Gjiqësor Shkodër, ku kërkon lëshimin e urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes të saj, nga bashkëshorti A.K..

Me Vendimin nr. 84 (1757), datë 04.05.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjiqësor Shkodër është vendosur pranimi i kërkesëpadisë së palës paditëse Shpresë Dardha (A.K.).

Në dispozitivin e këtij vendimi citohet:

“Gjykata, pasi shqyrtoi aktet si dhe shqyrtoi çështjen në tërësi, dëgjoji paditësen Shpresë A.K., e cila kërkoi lëshimin e urdhërit të mbrojtjes, të paditurin A.K., i cili nuk ishte dakord. Vendosi:

1. Pranimin e kërkesë padisë.

2. Vërtetimin e urdhërit të mbrojtjes lëshuar me vendimin nr. 76(1447), dt. 17.04.2022 të

Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

3. Lëshimin e urdhërit të mbrojtjes për paditësen Shpresë Dardha (A.K.) me urdhërimet e mëposhtëme:

- *Urdhërohet i padituri A.K. që:*
- *Të mos kryejë dhe të mos kërcënojë se do të kryejë veprime dhune ndaj paditëses Shpresë A.K..*
- *Të mos çënojë, ngacmojë, komunikojë apo kontaktojë drejtpërdrejtë apo tërthorazi me paditësen Shpresë Dardha (A.K.).*
- *Të largohet nga banesa bashkëshortore, banesë e cila ndodhet nëShkodër.*
- *Ky urdhër mbrojtje i shtrin efektet deri në datë **04.11.2022**.*
- *Shkelja e vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhërit të mbrojtjes përbën vepër penale, në kuptim të nenit 320 të Kodit Penal.....”.*

Nëpërmjet vendimit të sipërcituar, rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka kryer vërtetimin e një urdhëri mbrojtjeje të lëshuar për bashkëshorten e ankuesit, ndërkohë që rezulton se është lëshuar edhe më parë një i tillë në muajin prill 2022, nëpërmjet vendimit nr. 76(1447), datë 17.04.2022, të kësaj gjykate. Mbështetur në përmbajtjen e vendimit të shkurtuar nr. 84 (1757), datë 04.05.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër rezulton se ankuesi A.K. ka dhunuar bashkëshorten e tij. Pas shqyrtimit të akteve të disponuara në dosjen gjyqësore dhe pasi ka dëgjuar të dy palët, gjyqtari A.Y. ka vendosur për marrjen e masave të sipërpërmendura.

Në pikat 2-3, të nenit 21, të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar parashikohet se :

“2. Kundër vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes dhe vërtetimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes mund të bëhet ankim. Ankimi paraqitet brenda 5 ditëve nga shpallja e vendimit ose nga dita e marrjes dijeni. Gjykata e apelit vendos brenda 15 ditëve nga dita e regjistrimit të ankimit. Kundër vendimit të gjykatës së apelit nuk lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë.

Kundër vendimit të gjykatës që ka lëshuar urdhrin e mbrojtjes nuk lejohet ankim nga viktimi.”

3.Paraqitja e ankimit nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes apo të urdhrit të mbrojtjes.”

Në këtë kontekst, KMD gjykon se nuk ka kompetencë të japë mendim mbi ligjshmërinë e një vendimi gjyqësor të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, pasi ky vendim mund të kundërshtohet vetëm pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, e cila ka tagër ta rrëzojë apo ta lerë në fuqi. Komisioneri çmon se pretendimi i parashtruar nga z. A.K. është jashtë kompetencave, që LMD, i ndryshuar, i atribuon institucionit të KMD-së.

Në nenin 33, pika 4, gërma b) të LMD, të ndryshuar parashikohet se *“Ankesa nuk pranohet kur.... b) është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji.* Në rastin konkret, KMD gjykon që ankesa nr. 54/2022 nuk mund të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e LMD, të ndryshuar.

Për sa më sipër, KMD çmon se pretendimi i ankuesit nuk pranohet për shqyrtim.

➤ **Lidhur me pretendimin e dytë të ankuesit A.K.**

Masat e marra për mbrojtjen e bashkëshortes së z. A.K., në vendimin gjyqësor të sipërcituar, janë mbështetur në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 *“Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”*, i ndryshuar. Qëllimi i këtij ligji është parandalimi dhe reduktimi i dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore dhe të masave të tjera të nevojshme, si dhe garantimi i mbrojtjes me masa ligjore dhe me masa të tjera të nevojshme të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktima të dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuar, si dhe të çdo individ, subjekt i këtij ligji, sipas nenit 3, të tij, që paraqet nevoja të veçanta mbrojtjeje. Ky ligj bazohet në parimet e sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara *“Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”*, Konventën e Këshillit të Evropës, *“Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”* dhe në aktet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

Në pikat 2-3 të nenit 3/1, të këtij ligji përcaktohet shprehimisht se: *“2. Zbatimi i dispozitave të këtij ligji, veçanërisht masat për mbrojtjen e të drejtave të viktimave, sigurohen pa diskriminim, për çdo shkak të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi. 3. Masat e veçanta mbrojtëse, të parashikuara në nenin 10 dhe në nenin 13/1, të këtij ligji, që janë të nevojshme për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në marrëdhëniet familjare, nuk konsiderohen diskriminim nëse zbatohen sipas rregullave dhe kriterëve të parashikuar në këtë ligj.”*

Ankuesi A.K. e konsideron diskriminues ligjin e sipërcituar, për shkak të gjinisë dhe aftësisë së kufizuar, pasi në bazë të parashikimeve të këtij ligji ndaj tij, nga ana e gjykatës është marrë masa, që ai të largohet nga shtëpia e tij, ndërkohë që shteti nuk merr asnjë masë për strehimin e tij pas largimit nga shtëpia, aq më tepër kur ai është një person me aftësi të kufizuar.

Për sa më sipër, në nenin 10, pika 1, paragrafi 1, i gërmës a) të ligjit të sipërcituar parashikohet shprehimisht se: *“Gjykata, si masë mbrojtëse të dhunës në familje, urdhëron menjëherë largimin*

e dhunuesit nga banesa për një afat kohor të caktuar, kur viktimja dhe dhunuesi banojnë në të njëjtën strehë. Gjykata, kur është rasti, në vendosjen e kësaj mase merr në konsideratë nevojat e veçanta të dhunuesit të mitur, të moshuar ose personit me aftësi të kufizuar dhe në këto raste urdhri i largimit nga banesa vendoset vetëm kur asnjë masë tjetër nuk garanton mbrojtjen e viktimës nga dhuna....”

Nga sa më sipër, vihet re se pretendimi i ankuesit nuk qendron pasi ligji i sipërcituar ka kryer parashikimet përkatëse edhe mbi rastet kur dhunuesit janë me nevoja të veçanta. Ligjvënësi e ka lënë në çmimin e gjykatës marrjen në konsideratë të nevojave të veçanta të dhunuesit, në rastet kur ky i fundit është me aftësi të kufizuar. Në rastin konkret, gjykata ka gjykuar dhe vendosur se asnjë masë tjetër nuk është e mundur për mbrojtjen e viktimës nga dhuna dhe ka urdhëruar largimin e ankuesit nga banesa e përbashkët, deri në muajin nëntor 2022.

Në këto kushte, Komisioneri gjykon se një pretendim të tillë, ankuesi duhet ta bëjë të ditur pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, kur të kundërshtojë vendimin nr. 84 (1757), datë 04.05.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Në këtë kontekst, KMD shton faktin se edhe në rast se vendimi i sipërcituar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër lihet në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër, sërisht ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, ka ngarkuar disa institucione me detyrime të ndryshme, ku përfshihen edhe ndërmarrja e masave për trajtimin e dhunuesit.

Në këtë kontekst, Komisioneri vë theksin tek kompetencat e njësive të vetëqeverisjes vendore. Në nenin 7, pika 4, gërmat c), ç) e d), të ligjit të sipërcituar parashikohet shprehimisht se:

“4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, bazuar në parashikimet e legjislacionit në fuqi për vetëqeverisjen vendore, në kuadër të zbatimit të këtij ligji, kanë këto detyra:

.....

c) ngritjen e strukturave e të qendrave publike për trajtimin, trajnimin dhe rehabilitimin e dhunuesve;

ç) marrjen e masave, në bashkëpunim me organet ligjzbatuese, për ndarjen e dhunuesit nga familja, me qëllim lënien në përdorim të banesës familjare viktimës dhe fëmijëve;

d) marrjen e masave për zbatimin e vendimit gjyqësor, nga organet vendore të vendbanimit dhe/ose vendqëndrimin të viktimës.”

Vlen të theksohet fakti se në pikën 5, të nenit 7 të këtij ligji parashikohet gjithashtu se:

“Ministria përgjegjëse për çështjet e strehimit, mbështet me financime njësitë e vetëqeverisjes vendore për sigurimin e banesave të specializuara, sipas legjislacionit në fuqi për strehimin social.”

Në interpretim të dispozitës së sipërcituar, Komisioneri gjykon se ligjvënësi e ka rregulluar edhe çështjen e strehimit të dhunuesve, të cilët me hyrjen në fuqi të urdhërit të mbrojtjes, të lëshuar nga gjykata, duhet të largohen nga banesa e përbashkët dhe nuk kanë banesë tjetër për të jetuar. Kopja e vendimit gjyqësor për lëshimin e vërtetimit për urdhërin e mbrojtjes i dërgohet menjëherë edhe organeve të njësisë të vetëqeverisjes vendore, strukturat përgjegjëse të së cilave marrin masat përkatëse.

KMD e rekomandon ankuesin që t’i drejtohet me kërkesë me shkrim organeve të Njesisë Administrative, ku ai banon duke u bërë të qartë nëpërmjet akteve administrative që ai disponon, aftësinë e kufizuar dhe pamundësinë për patur banesë tjetër, me qëllim që këto struktura të marrin masat përkatëse për strehimin e tij të përkohshëm deri në datën 04.11.2022.

Në nenin 33, pika 4, gërma b) të LMD, të ndryshuar parashikohet se *“Ankesa nuk pranohet kur.... ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”*. Në rastin konkret, KMD gjykon që ankesa nr. 54/2022 nuk mund të pranohet pasi është haptazi e pabazuar.

Në rastin konkret, KMD gjykon se pretendimi i dytë i z. A.K. është haptazi i pabazuar.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 7, pika 3, nenin 21, pika 1, nenin 20, nenin 32, pika 1, gërma b) dhe pika 2, gërma ë), nenin 33, pika 4, gërmat b) e ç), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës nr. 76, datë 12.05.2022, e z. A.K., pasi është haptazi e pabazuar dhe e papajtueshme me dispozitat e ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë

Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha – Të mira e shërbime
Shkak – aftësi e kufizuar
Lloji i vendimit - mospranim